

SUPORTI NDAJ KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT, PJESË INTEGRALE E SUPORTIT NDAJ MIREQEVERISJES FINANCIARE.

nga Luljeta NANO – Sekretare e përgjithshme,

Albana AGOLLI – Drejtore Departamenti,

botuar në gazetën “Ekonomia”, më 15 qershor 2014.



Në përputhje me Deklaratën e Limës e cila konsiderohet Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) dhe me Standardin e ri “Mbi vlerat dhe për përfitimet e një SAI” në sistemin funksional të përgjegjshmërisë, KLSH sikurse të gjitha Institucionet analoge kudo në bote, nëpërmjet veprimtarisë audituese kontribon në përdorimin efektiv dhe të përshtatshëm të fondeve publike, zhvillimin dhe forcimin e menaxhimit financiar, dhe në informimin e publikut dhe autoriteteve publike.

Impakti i rezultateve të mësipërme padyshim shoqërohet me një rritje të performancës në kryerjen e shërbimeve publike, minimizimin dhe efektive të keqmenaxhimit, mashtrimit, shpërdorimit dhe korrupsionit në arritjen e objektivave politike sikurse është ulja e varfërisë etj.

Një nga impaktet kryesore është rritja e transparencës përgjegjshmërisë dhe ligjshmërisë nëpërmjet rritjes së besimit të publikut forcimit të rolit të parlamentit drejt ekzekutivit e përmirësimit të jetës së qytetareve.

Nëse do të shqyrtonim trekëndëshin e llogaridhënies publike, Institucionet Supreme të Auditimit dhe Parlamenti janë elemente të një sistemi të balancuar të llogaridhënies.

Referuar strategjive të projektuara si dhe literaturës në përgjithësi për këtë çështje Institucionet Supreme të Auditimit së bashku me Komisionet Parlamentare konsiderohen si një nga shtyllat kryesore të cilat realizojnë një mbikqyrje efektive të financave publike.

KLSH në qasjen e mirë qeverisjes financiare, është një pjesë dhe komponent i qenësishëm dhe mjaft i rëndësishëm.

Mirëqeverisja në vetevete nënkupton një veprimtari legjitime, transparente dhe të orientuar drejt zhvillimit në fushën e financave publike në të ardhurat dhe shpenzimet dhe që përfshin administrimin financiar eficient dhe të përgjegjshëm, institucione shtetërore që operojnë bazuar në shtetin e së drejtës, si dhe institucione efektive të auditimit.

Për KLSH kjo nënkupton që të asistojë në forcimin e aspektit normativ të punës së tij dmth modernizimin e kuadrit rregullator ligjor dhe zhvillimin e tij si një institucion ne funksion dhe ndihme të llogaridhënjes dhe që luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e legjitimitetit dhe të transparencës.

Por me synim që të jetë një institucion më efektiv dhe llogaridhënës, si një parakusht KLSH duhet të pajiset me një instrument të fuqishëm ligjor për të luajtur rolin e tij.

Referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor, KLSH është një institucion i targetuar për realizimin e mbikqyrjes parlamentare por në kushtet aktuale ky institucion nuk mund të realizojë dhe të mbikqyrë ligjshmërinë dhe eficiencën e ekzekutimit të buxhetit.

Kjo për efekt të një aksesit të limituar që KLSH ka në marrjen e informacionit dhe kufizimit të fushës së auditimit në administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet tatimore. Administrimi i taksave është një nga komponentet kryesore të shtyllës së reformës së menaxhimit të financave publike e që ka të bëjë me një ekzekutim eficient të buxhetit.

Reforma në administrimin e taksave për të përmirësuar mbledhjen e të ardhurave nuk mund të konsiderohet e efektshme pa një mbikqyrje efektive nga trupa e auditimit të jashtëm sikurse është KLSH.

Në të vërtetë ky institucion, referuar funksioneve kushtetuese ligjore është institucioni i cili realizon mbikqyrjen financiare mbi të gjitha zërat buxhetorë si në shpenzimet dhe te ardhurat buxhetore.

KLSH sikurse të gjithë institucionet supreme të auditimit duhet të ketë kompetencë të auditojë dhe shqyrtojnë veprimtarinë e gjithë ekzekutivit. Këto institucione kanë rol aktiv në zhvillimin e ciklit buxhetor dhe japin opinionin e tyre mbi menaxhimin, administrimin dhe zbatimin e buxhetit si dhe llogaritë e qeverisë të vitit të kaluar financiar.

Bazuar në nenin 158, të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave është i detyruar të paraqesë raport Kuvendit lidhur me zbatimin e buxhetit me pas Kuvendi vendos përfundimisht pasi dëgjon edhe raportin e KLSH-së.

Sikurse u theksua dhe me lart roli i KLSH-së është dhënja e një opinionin mbi zbatimin e ligjshmerisë nga ekzekutivi dhe dhënja e rekomandimeve për përmirësimin e administrimit të të ardhurave dhe menaxhimit të shpenzimeve në përgjithësi. Si mundet KLSH në funksion të përmbushjes së detyrimit kushtetues (neni 164 i Kushtetutës) të japi opinion mbi administrimin e buxhetit të të ardhurave buxhetore (nder te tjera te ardhurat e administruara nga organet e tatim taksave) në kushtet e limitimit të aksesit në dokumentacion. Për rrjedhojë kjo sjell efekte të menjëhershme në cënimin e kryerjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore.

Për kryerjen e këtij misioni KLSH duhet të ketë një kornizë dhe mandat ligjor që është në një linjë me standartet e INTOSAI dhe një pavarësi reale dhe operacionale, burimet e nevojshme përfshi autoritetin mbi stafin dhe politikën e pagave dhe një dallim të pastër për rolin e tij dhe mandatin nga trupat e brendshme audituese, kontrolluese apo ato antikorrupsion.

Në kuadrin e procedurave të ndërmara për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 ndër gjashtë shtyllat dhe prioritetet e kësaj strategjie, dy shtylla janë të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrën; shtylla e tretë që ka të bëjë me ekzekutimin eficient të buxhetit dhe shtylla e gjashtë, që ka të bëjë me mbikqyrjen efektive të financave publike. Nëse do të shqyrtohen objektivat e shtylles së ekzekutimit efektiv të buxhetit, komponent kryesor është menaxhimi i të ardhurave. Një mbikqyrje efektive e menaxhimit të taksave është e lidhur drejtpërsëdrejti me efektivitetin e menaxhimit të tyre.

Suksesi i strategjisë për reformën e menaxhimit të financave publike është i varur dhe ndikuar tërësisht nga mbikqyrja efektive parlamentare dhe kjo e fundit realizohet nëpërmjet KLSH-së.

Nëse KLSH nuk disponon të drejtën e ushtrimit të funksioneve kushtetuese dhe ligjore dhe limitohet në mandatim apo në aksesin e e ushtrimit të veprimtarisë, nëse ligji i ri organik i KLSH-së i cili është në proces shqyrtimi, nuk do të miratohet në konformitet me praktikat më të mira të fushës dhe standardet ndërkombëtare të auditimit pa dyshim që jo vetëm nuk do të ketë mbikqyrje efektive të financave publike por cënim të detyrimeve kushtetuese të KLSH-së.

Në këtë këndvështrim mund të thuhet se roli i KLSH-së, është i lidhur ngushtësisht me mirëmenaxhimin e financave publike, por jo vetëm.

KLSH si Institucioni Suprem i Auditimit ne vend, duhet ti jepet mundësia por edhe suporti që nëpërmjet impaktit pozitiv mbi efincencën edhe efektivitetin e përdorimit të fondeve shtetërore për lëvrimin e shërbimeve publike të ndikojë në rritjen e përgjegjshmërisë dhe të kontribuojë në mirëqeverisjen financiare.